

Kënga e Vitit – Muajt

Teksti dhe Muzika: Desara Beqari Gjonej

Në janar i gëzohem borës.
Në shkurt i këndojmë Kosovës.

Në mars, prill dhe maj
çelin lule plot.
Në qershor, korrik dhe gusht
bëjmë në det not.

Në shtator – sërish në shkollë!
Në tetor hamë dardhë e mollë.

Në nëntor festojmë për flamur e për liri.
Në dhjetor urojmë “Gëzuar Vitin e Ri!”
Dhe kështu kalon një vit!
Hej! Kënga jonë do të bëhet hit! Hit! Hit! Hit!

|

Vendosi në tekst fjalët që mungojnë: dardhë • bëjmë • Kosovës • liri • nëntor • kalon • borës • Gëzuar • shkollë • janar • bëhet • çelin • qershor

Kënga e Vitit – Muajt

(Teksti dhe Muzika: Desara Beqari Gjonej)

Në _____ i gëzohem _____ .
Në shkurt i këndojmë _____ .

Në mars, prill dhe maj
_____ lule plot.

Në _____ , korrik dhe gusht
_____ në det not.

Në shtator – sërish në _____ !
Në tetor hamë _____ e mollë.

Në _____ festojmë për flamur e për _____ .
Në dhjetor urojmë “ _____ Vitin e Ri!”
Dhe kështu _____ një vit!
Hej! Kënga jonë do të _____ hit! Hit! Hit! Hit!

